



HEC LANABREGAS SH.A.



Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT PERFUNDIMTAR

29.09.2023

*BOE “Inply shpk & Muhoplus LTD shpk”**Nipt L51503032Q & NIPT L52317046G**Adresa: “Kompleksi Dilo, Hyrja 3, Ap 1” & “Njesia Administrative Nr.7, Rruga Ded Gjo Luli, Pall 2, Shkalla Nr.2, Ap Nr.4”*

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur, prokurim publik me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF – 77437-08-15-2023**Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Rikonstrukion i Seksionit 6kV në HEC Lanabregas sh.a. (Faza e Dytë)”*. Fondi limit: 35,866,371.67 (tridhjetë e pesë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nje pike gjashtëdhjetë shtate) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: Duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 3 (tre) muajve.

Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “HTM” shpk

NUIS K97006004D

Vlera e ofertës = 28,334,050 (njëzetë e tetëmilionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. BOE “Inply shpk & Muhoplus LTD shpk”

NUIS L51503032Q & L52317046G

Vlera e ofertës = 34,731,300 (tridhjetë e katërmilionë e shtatëqind e tridhjetë e njëmijë e treqind) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik “AZ Trading” shpk

NUIS L81515016F

Vlera e ofertës = 35,250,534 (tridhjetë e pesë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik “HTM” shpk

NUIS K97006004D

Operatori Ekonomik “HTM” Shpk nuk plotëson pikën Nr.1.a. “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit”, sipas shtojcës 8, ku OE nuk ka plotësuar saktë/siç është kërkuar Shtojcën 8 - Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit. Në kundërshtim me **Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit piken B. DEKLARATA**, pika 2. *Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt, ne Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË*, OE ka deklaruar “Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me **Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit** të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor”, ndërkohë që është kërkuar të deklarohej si në vazhdim: “Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me **preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve** të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.”. Në këtë rast, deklarata e OE nuk është e plotë dhe e saktë në çdo aspekt.

Operatori Ekonomik “HTM” Shpk nuk plotëson pikën 2.3 Kapaciteti teknik: “2.3.1 Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet të ketë realizuar të paktën: **a. Punë të ngjashme** për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ose **b. Punë të ngjashme** deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH)”. **Kontrata e paraqitur si pune e ngjashme** nga OE **nuk është kontrate punimesh**, por **kontratë furnizimi** mallrash, siç është cilësuar dhe në kontratën mes palëve “HTM” ShPK dhe “FUSHA” ShPK e paraqitur nga OE, dhe në certifikatat e marrjes në dorëzim të mallrave që OE ka furnizuar nëpërmjet kësaj kontrate. Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentat e tenderit, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Në këtë rast OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument që vërteton se ka kryer punë të ngjashme të realizuara me sukses.

Operatori Ekonomik “HTM” Shpk nuk plotëson pikën 2.3.5, pika 1: “*Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij*”. OE ka paraqitur autorizim nga distributori “Albaelettrica”, nga i cili është i autorizuar **vetëm për produktet**: Kabllo të kontrollit të tensionit të ulet, kapikorda CU-Al me seksion 35-150mm², kapikorda CU me seksion 35-150mm² dhe rrjedhimisht nuk përfaqëson autorizimin për mallrat: Pjesët rezerve:

Çelës fuqie i tipit me tërheqje. Un=6/7.2 kV, 630A, 25kA/3s (për pjese rezerve), Bobina ckyçje për çelësin 6/7.2 kV, Bobina kyçje për çelësin 6/7.2 kV, Bobine cbllokimi e karoces se celesit 6/7.2 kV, Kontakte ndihmese për pjesën e lëvizshme të çelësit 6/7.2 kV, Kontakte për pjesën fikse të çelësit 6/7.2 kV, Motor për karikimin e sustës së çelësit 6/7.2 kV, Transformator tensioni 6 kV të çelës së gjeneratorit sipas specifikimeve teknike, Transformator tensioni 6 kV të çelës së matjes sipas specifikimeve teknike, Rele mbrojtje inteligjente elektronike për mbrojtjen e gjeneratorit (për pjese rezerve), Siguresa 6/7.2 kV63A, Siguresa 6/7.2 kV16A.

Operatori Ekonomik “HTM” Shpk nuk plotëson piken 2.3.5, pika 2. “*Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedë teknike të prodhuesit për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike bazë të përkthyer në gjuhën shqipe*”. Skeda teknike e paraqitur për çelatat tregon mospërputhje me dimensionet e çelës nga ato që janë kërkuar, pasi është kërkuar me dimensione 800*2300*1500mm, ndërkohë OE ka ofertuar dimensionet 600*2510*1550. Siç është cilësuar dhe në specifikimet teknike, faqe 3, paragrafi i fundit: *Dimensionet janë të rëndësishme të jenë fikse, në mënyrë që të përshtaten me dimensionet e çelave ekzistuese. Mospërshtatja me dimensionet e çelave ekzistuese mund të çojë në pamundësi të montimit të zbarave ndërmjet çelave të reja dhe atyre ekzistuese.*

2. Operatori Ekonomik “AZ Trading” shpk

NUIS L81515016F

Operatori Ekonomik ka mungesë të theksuar dokumentacioni, pasi nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Publike asnjë dokument që vërteton kriteret e vecanta të kualifikimit si më poshtë:

Pika 1.a. nuk ka paraqitur sigurim oferte;

Pika 2.1.1 nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 45001: 2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë";

Pika 2.3.1 nuk ka ngarkuar asnjë dokument që tregon pervojën me punët e ngjashme të mëparshme;

Pika 2.3.2 nuk ka paraqitur Deklaratë për Drejtuesin Teknik;

Pika 2.3.3 nuk ka deklaruar Drejtues Teknik Ing. Mekanik në Formularin e Vetëdeklarimit;

Pika 2.3.4 nuk përmbush minimumin prej 10 punonjësish të punësuar pranë shoqërisë për 3 muajt e fundit, sipas të dhënave të Shtojcës Nr. 8;

Pika 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 nuk ka ngarkuar asnjë dokument në lidhje me kriteret e përcaktuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE “Inply shpk & Muhoplus LTD shpk” me NIPT L51503032Q & L52317046G dhe adresë “*Kompleksi Dilo, Hyrja 3, Ap 1*” & “*Njesia Administrative Nr.7, Rruga Ded Gjo Luli, Pall 2, Shkalla Nr.2, Ap Nr.4*”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 34,731,300 (tridhjetë e katërmilionë e shtatëqind e tridhjetë e njëmijë e treqind) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë HEC Lanabregas sh.a, Ruga e Kavajes, Ish Parku i Automjeteve sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

ADMINISTRATOR

Olsi Isufaj